



Hyrje

Ky dokument paraqet planin strategjik të CRA-së (Community Reporters Albania) për periudhën tre vjeçare 2023-2026. Plani strategjik i CRA-së

- Bazohet në një analizë të zhvillimeve kryesore mediatike dhe shoqërore në Shqipëri, zhvillime që mund të kenë ndikim në fushën e mediave, në fushën e të drejtave të njeriut dhe të komuniteteve të marxhinalizuara dhe për rrjedhojë edhe në punën e CRA gjatë tri viteve të ardhshme.
- Reflekton një rivlerësim të vizionit, misionit dhe vlerave mbi të cilat është bazuar puna e CRA-së gjatë tri viteve të shkuara.
- Parashton objektiva strategjike të CRA-së për periudhën 2023-2026 dhe programet që organizata do të vërë në jetë për të arritur këto objektiva si dhe
- Parashikon disa ndryshime në qasjen e CRA-së për të rritur cilësisht raportimet për zbatimin e këtij plani, me synim forcimin e kapaciteteve të organizatës në përputhje me standartet më të mira vendase dhe ndërkombëtare.

Plani strategjik do të udhëheqë punën e bordit, të ekzekutivit dhe anëtarëve të CRA-së për tre vitet e ardhshme.

Plani strategjik reflekton:

I. Takimin e mbajtur me anëtarët e stafit në formatin hibrid (në zyrat e CRA-së në Tiranë dhe përmes zoom-it me një pjesëmarrës) më datë 13 janar. Në këtë takim u diskutuan gjerësisht, arritjet e CRA-së gjatë tri viteve të shkuara, mësimet e nxjerra. Në këtë takim u bë një analizë SëAT.

II. Mësimet e nxjerra nga aktivitetet e periudhës 2020 -2022, rekomandimet dhe sugjerimet e marra në rrugë formale dhe informale.

III. Konsultimet e realizuara me ekspertin e ngarkuar për hatimin e strategjisë.

IV. Statutin e organizatës.

V. Aktivitetet e deritanishme të organizatës

Histori

Më 30 tetor 2020 në gjykatën e rrethit gjyqësor Tiranë është regjistruar qendra “Community Reportes Albania” me synim promovimin e gazetarisë qytetare në Shqipëri dhe fuqizimin e anëtarëve të minoritetit rom dhe egjiptian, për t’u bërë zyra të ndërgjegjshëm qytetar në përputhje me vlerat e një shoqëri gjithë pranuese, tolerante dhe të angazhuar për të drejtat dhe liritë e njeriut.

Për të përmbushur misionin e saj CRA është e angazhuar në:

- Orimin e praktikave periodike trainimi për gazetarinë online, televizionin, raportimin live, montazh video, audio prodhim ëeb media, blog etj.
- edukimin dhe sensibilizimin e publikut për rëndësinë e mediave në ndërtimin dhe ruajtjen e një demokracie ligjore dhe funksionale.
- promovimin e nismave për afirmimin e të drejtave themelore të individit dhe favorizimin dhe integrimin mediatik dhe social të kategorive në nevojë.
- promovimin e nismave për afirmimin e të drejtave themelore të individëve dhe favorizimin e integrimin mediatik dhe social të kategorive në nevojë.
- mbështetjen mediatike për nisma të ndryshme sociale nga komunitete dhe organizata jo fitimprurëse me akses të kufizuar mediatik
- zhvillimin dhe bashkëpunimin me partnerë, subjekte publike dhe private, institucione mediatike, instituicone që ushtrojnë veprimtari social kulturore apo që kanë qëllime të ngjashme.
- këshillimin e institucioneve publike dhe subjekteve të tjera për çështje të hartimit të politikave të ndryshme mediatike dhe sociale.
- bashkëpunimin me grupet identitare për përmbushjen e qëllimit.
- realizimin e projekteve dhe aktiviteteve që kanë ndikim të rëndësishëm në zhvillimin dhe integrimin e komuniteteve rom dhe egjiptiane.
- hulumtimin dhe dokumentimin, promovimin e kulturës dhe identitetit dhe modeleve pozitive të komuniteti rom dhe egjiptian.
- bashkëpunimin me televizione të ndryshme për krijimin dhe organizimin e emisioneve të cilat nxisin reagimin qytetar dhe aktivizmin.
- Analiza mbi probleme sociale dhe ligjore në kuadër të nxitjes së politikave, për përmirësimin e jetesës së komunitetit rom dhe egjiptian.
- hartimin e raporteve që kanë të bëjnë me median komunitare, çështjet sociale dhe ligjore.

Aktivitetet kryesore të CRA-së

Në muajin Shkurt 2021, CRA mori mbështetjen e parë nga Albania Center for Quality Journalism (ACQJ) për “Investigimin e projektit qeveritar të “100 fshatrave turistike” ku investigoi 5 fshatra në disa qytete në Shqipëri. Ky projekt ishte 6 muaj (Shkurt-Korrik

Në muajin Prill 2021, CRA mori mbështetjen e dytë nga European Endowment for Democracy (EED) e cila mbështeti qendrën për rritjen e kapaciteteve të saj në raportimin mediatik, ndihmoi të pajisej me aspektet teknike për realizimin e prodhimeve dhe pjesa e dytë që i kushtojë prodhimin të artikujve multimedial për raportimin komunitar për problematikat sociale-ligjore për

Minoritetin Rom dhe Egjiptian, përpos kësaj me mbështetjen e EED, CRA kreu monitorimin e zgjedhjeve parlamentare 2021 për herë të parë me vëzhgues nga romët dhe egjiptian si dhe publikoi raportin e monitorimit dhe gjetjet nga vëzhgimii zgjedhjeve.

Gjithashtu CRA në këtë projekt publikon raportin e parë kërkimor në lidhje me aksesin e shërbimeve publike dhe problematikave të Romëve në 7 bashki ku kemi raportuar, si dhe publikimi i investigimit për planet vendore të minoritetit Rom dhe Egjiptian në 2 bashki (Fier dhe Elbasan). Ky projekt 12 muaj i përket periudhës Prill 2021-Prill 2022.

Në muajin Gusht 2021, CRA mori mbështetjen e tretë nga ambasada amerikane në Tiranë.

Përmes këtij projekti do të ndërtohej një grup rinor raportues lokal nga minoriteti Rom dhe Egjiptian në bashkinë Elbasan dhe Fier për të bërë më aktiv në komunitetin e tyre në lidhje me problematikat që kanë.

Gjatë zbatimit të këtij projekti, CRA me raportuesit lokal ka arritur disa fitore të vogla, por të rëndësishme për jetën e banorëve, në Elbasan. Për shembull në një lagje rome prej 50 familje u vendos ndriçimi publik pas më shumë se 30 vitesh. Ndërsa në Fier, në fshatin Baltëz ku jetojnë rreth 200 familje rome, u vendos ndriçimi publik dhe tani janë në pritje për pastrimin e “Vijës së Ngjalës” degëzim i lumit Gjanica.

Në Durrës, në fshatin Kullë jetojnë rreth 50 familje rome, prej 3 muajsh ata nuk furnizoheshin me ujë të pijshëm përshkak të rregullimit të linjës së re të Ujësjellësit dhe ndërprerjes për shkak se banorët nuk kishin kontrata. Pas ndërhyrjes të CRA dhe banorëve pas 1 muaji furnizimi me ujë për banorët u garantua.

Aktualisht, Community Reporters Albania është duke zhvilluar gazetarinë komunitare e cila bashkëpunon ngushtësisht me aktivistët në 7 qytete në Shqipëri (Tiranë, Durrës, Shkodër, Fier, Berat, Elbasan dhe Korçë) ku problematikat që shfaqin qytetarët ndiqen në rrugë duke advokuar në media, me shkresa, kërkesa si raste strategjike në media, CRA raporton gjithashtu për fusha si: Strehimi, Arsimi, Shëndetësia, Punësimi, Diskriminimi dhe Sociale. Tashmë prej 2 muajsh CRA është duke prodhuar episode “Podcaste” kushtuar mbrojtësëve të njeriut si një vlerë në shoqërinë tonë.

Në muajin Mars 2022, CRA mori mbështetjen e katërt nga Media Center Sarajevo (British Institute). Kjo mbështetje u fokusua me trajnimet për ngritjen e kapaciteteve për të realizuar shkrime cross-board me mentor nga mediat ndërkombëtare si BBC, BIRN etj. Gjatë implementimit të këtij projekti 2-mujor, CRA realizoi një shkrim cross-board në lidhje me Open Balkan në bashkëpunim me një organizatë mediatike serbe Zoomer e cila mori çmimin e parë në një konferencë në Sarajevë.

Struktura organizative e CRA-së

Qendra është një organizatë pa anëtarësi, me statusin e një organizate jo fitim prurëse. CRA drejtohet organizohet dhe administrohet nga bordi i drejtorëve dhe drejtori ekzekutiv. Bordi i Drejtorëve është organi më i lartë vendimarrës i CRA-së. Bordi drejton gjithë veprimtarinë e qendrës dhe merr vendime për çështje me synime afatgjata dhe afatshkurtra. Vepimtari e përditshme e Qendrës udhëhiqet nga Drejtori Ekzekutiv..

Drejtimi Strategjik

a. Vizioni

CRA beson dhe punon për zhvillimin e një shoqërie të lirë ku askush nuk diskriminohet, ku ligji dhe të drejtat janë të barabarta për të gjithë, pavarësisht nga përkatësia racore apo simpatitë politike. CRA beson se mbrojtja, promovimi dhe përmirësimi i gjendjes së komunitetit rom dhe egjiptian arrihet përmes angazhimit, bashkëpunimit, tolerancës mes qytetarëve dhe vullnetit politik dhe institucional për të mbrojtur të drejtat e individit dhe komuniteteve të marginalizuara. CRA beson në rolin emancipues të medias përmes sensibilizimit, ekspozimit të problemeve dhe paraqitjes së modeleve pozitive.

b. Misioni

Misioni i CRA konsiston në bashkëpunimin me organizata dhe aktorë të spikatur të shoqërisë civile për të bashkuar kontributet në respektimin e të drejtave të njeriut dhe komuniteteve në përputhje me Kushtetutën dhe aktet ndërkombëtare.

Në përmbushje të statutit të CRA-së është theksuar

- I. Informimi, ndërgjegjësimi dhe ofrimi i trainimeve falas për anëtarë të komunitetit rom dhe egjiptian.
- II. Monitorimi, advokimi dhe mbrojtja në mënyrë pro aktive në bashkëpunim edhe me media të tjera dhe aktorë të shoqërisë civile për respektimin e të drejtave të komuniteteve të marginalizuara.
- III. Përgatitja e raporteve për opinionin vendas dhe ndërkombëtar për zbatimin e të drejtave të komunitetit rom dhe egjiptian në Shqipëri.
- IV. Ofrimi ekspertizës së CRA-së në lidhje me raportimin e çështjeve që shqetësojnë komunitetin rom dhe egjiptian
- V. Forcimi i kapaciteteve të organizatës, por edhe ngritja e kapaciteteve në komunitet për të mbikqyrur dhe monitoruar angazhimet publike të politikanëve dhe administratës lokale.
- VI. Reagim publik në rastet e cënimit të të drejtave që këtij komuniteti ia njeh ligji dhe Kushtetuta e Shqipërisë, si dhe referimin e tyre në organet kompetente.

c. Vlerat

Gjatë tri viteve të para të aktivitetit të saj CRA e bazon punën e vet në parime të rëndësishme si:

Përkushtimi ndaj misionit të mbrojtjes dhe promovimit të të drejtave të individit dhe komuniteteve të marginalizuara.

Pavarësia nga politika, nga partitë politike dhe qeveria duke mos pranuar financime apo mbështetje, duke mos toleruar asnjë ndikim të jashtëm që cënon misionin e organizatës.

Integriteti profesional dhe etik i aktivitetit mediatik të CRA-së dhe bashkëpunëtorëve të saj, duke qenë shembull në respektimin e standarteve dhe të etikës. Në kohën e rrjeteve sociale një kujdes të veçantë CRA i kushton privacisë së individit.

Transparenca do të thotë që CRA ofron qasje të gjerë për gjithë aktivitetin e vet, projektet që zbaton, donatorët që ka, rekomandimet në veprimtarinë e vet.

d. Përparësitë konkurruese

Pikat e forta të CRA	Sfidat e brendshme të CRA-së
<ul style="list-style-type: none"> ● Kontaktet të mira me pushtetin lokal ● Aksesi dhe besimi në komunitet. Marrëdhënie konstruktive bashkëpunimi dhe komunikimi me komunitetin. ● Gazetari komunitare/gazetari avokuese ● Target grup i përcaktuar. Profilizimi i organizatës. ● Përvoja prej 30 muajsh- rastet e suksesit. ● Staf i dedikuar- gazetarë. ● Aktivistët lokalë, korrespondetët. Pika kontakti të përhershme në 7 bashki ● Vizibiliteti në median sociale dhe tradicionale ● Ofrimi i trainimeve mediatike për të rinjtë e komunitetit rom dhe egjiptian 	<ul style="list-style-type: none"> ● Mungesa e anëtarësisë, për shkak se Qendra nuk funksionon me anëtarë krijon vështirësi për të reaguar shpejt dhe për të thithur mendime të ndryshme por edhe për të zbatuar shpejt projekte që kërkojnë staf të gatshëm. ● Kapacitete të pamjaftueshme për shfrytëzimin e duhur të teknologjisë së informacionit për publikimin dhe shpërndarjen e shpejtë të Materialeve. ● Mungesë e mbështetjes financiare të qëndrueshme për zhvillimin institucional. ● Varësia 100% vetëm nga donatorë të huaj. ● Mjedis relativisht i kufizuar në selinë qendrore çka krijon pengesa për rritjen e stafit dhe organizimin e trainimeve ● Qira, relativisht e lartë për ambientet e punës. ● Burime të kufizuara njerëzore. Vështirësi për të identifikuar staf

	<p>cilësor sidomos në hartimin e projekteve.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Burime të kufizuara në ekspertë që mbulojnë çështje të komuniteteve rom dhe egjiptian. • Mungesa e një strategjie komunikimi të organizatës sa i përket komunikimit me median dhe publikun. • Rrjeti i korrespondentëve të CRA-së nuk është gjithnjë aktiv dhe i motivuar. <p>Paqëndrueshmëria e administratës lokale. Sfidë mbetet si do të jetë administrata dhe a do të jenë sërish pikat e kontaktit në 7 bashkitë.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Përkeqësimi i zbatimit të ligjit 119/2014 për të drejtën e informimit të publikut me dokumenta zyrtare. <p>Mbingarkesa e gjykatave dhe për rrjedhojë vonesa të konsiderueshme në trajtimin e çështjeve gjyqësore që ngre CRA në dobi të komuniteti.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Klima mediatike e orientuar kryesisht nga politika, lajmet sensacionale dhe kronika rozë. Kjo vështirëson fokusin e gazetarëve dhe mediave drejt problemeve sociale në përgjithësi dhe problemeve të komunitetit rom dhe egjiptian në veçanti.
--	---

COMMUNITY
REPORTERS
ALBANIA

<p>Mundësitë për CRA</p> <ul style="list-style-type: none"> • Trainime për menaxhim më të mire, financiar si dhe trainime të vazhdueshme për shkrimin e raportimin e lajmit. 	<ul style="list-style-type: none"> • Rreziqet... <p>Fonde të pamjaftueshme. Vakume gjatë gjithë vitit. Puna bazuar vetëm në projekte..</p>
--	--

<ul style="list-style-type: none"> ● Identifikimin dhe vendosjen e kontakteve më të mira me donatorët e huaj dhe vendas. ● Zgjerimi i kontakteve me komunitetin (nga 7 bashki në 15) ● Forcimi i bashkëpunimit me organizata partnere në rajon. Shpreshtimi i kontakteve. ● Rritja e vizibilitetit në median tradicionale. ● Bashkëpunimi me universitetin. Internship për studentët. - ● Bashkëpunimi me organizata jo qeveritare që ofrojnë shërbim ligjor falas për gazetarët dhe komunitetet në nevojë. - ● Ndërgjegjësim më i madh te komuniteti për çfarë bën dhe çfarë ofron CRA. - ● Zbutja e “rivalitetit” me organizata lokale që kanë frikë se “i marrim territorin” 	<ul style="list-style-type: none"> ● Mos bashkëpunimi i pushtetit lokal me koordinatorët. Vendosja nën presion e koordinatorëve. ● Rritja e mosbesimit tek media. ● Rivaliteti me organizatat lokale.. ● Ndryshimi e kontakteve në pushtetin lokal si pasojë e zgjedhjeve. ● Mos zbatimi i ligjit 119/2014 për të drejtën e informimit të publikut me dokumenta zyrtare. ● Paragjykimet, komentet negative në rrjetet sociale për komunitetin rom-egjiptian. ● Mungesa e të dhënave të sakta, mungesa e censusit për të ditur me saktësi ku është komuniteti dhe të dhënat e sakta. ● Migrimi dhe emigrimi i anëtarëve të komunitetit. ● Mungesa e liderëve në komunitet.
--	--

Disa prej zgjidhjeve që do të përdoren nga CRA për kapërcimin e sfidave dhe rreziqeve

- a) Ndjekja e hapave ligjorë në rastet e moszbatimit nga administrata lokale ose qendrore të ligjit për të drejtën e informimit me dokumenta zyrtare.
- b) Advokimi strategjik me donatorë afatgjatë dhe identifikimi i donatorëve të rinj për mbështetjen institucionale të CRA-së
- c) Buxhetimi në projekte për të bërë më vizibël markën e CRA-së në vend, te komuniteti i donatorëve, në komunitet dhe në media.

- d) Trajnime të vazhdueshme për stafin brenda dhe jashtë vendit dhe nxitja për pjesëmarrje në seminare, konferanca, aktivitete, pritje, trainime me synim për të bërë të mundur plotësimin e pikës b) dhe c)
- e) Punësimi me kohë të plotë i dy gazetarëve.
- f) Rritja e audiencës në rrjete sociale nga 200 mijë për 2022 në 1 milionë në fund të vitit 2024.
- g) Publikimi i afro 250 shkrimeve/historive çdo vit deri në fund të 2026.
- h) Kontakte dhe komunikim më i mirë me institucionet ku merren vendime për komunitetin. (këshillat bashkiakë)
- i) Prani të CRA në diskutimet për buxhetet lokalë.
- j) Prani të CRA-së në diskutimet në komisionet relevante parlamentare.
- k) Më shumë ekspozim përmes shkrimeve investigative. (gazetari multimediale, më shumë video dhe podcaste)
- l) Ideimi dhe aplikimi për projekte që i japin rol korrespondentëve lokalë dhe pikave të kontaktit të CRA-së në rrethe.
- m) Rritja e ndërgjegjësimi të komunitetit për problematikat dhe mundësitë e zgjidhjes.
- n) Monitorimi i premtimeve specifike që i bëhen komunitetit nga përfaqësues lokalë, deputët dhe politikanë.
- o) Identifikimi i rasteve abuzive në komunitet nga administrata, bizneset etj.
- p) Identifikimi i problemeve dhe jo fokusimi vetëm te problemet bazike në komunitet (drita, ujë, strehim)
- q) Pika kontakti në të gjitha bashkitë ku jeton komuniteti rom dhe egjiptian.
- r) Më shumë lider të komunitetit rom/egjiptian.
- s) Më shumë “suçes story” të rinjtë e komunitetit, përmes trainimeve dhe ndihmës që do t’i jepet të rinjve të komunitetit.
- t) Komunikim më i mirë me median.
- u) Advokimi i çështjeve të mprehta të komuniteti në media dhe përfaqësim ligjor në gjykatë.

Lista e Aktivitete

1. Mbulimi dhe raportimi i zgjedhjeve lokale sidomos për vendimet dhe veprimet që ndikojnë komunitetin rom dhe egjiptian.
2. Vendosjen prioritare të çështjeve dhe sfidave me të cilat ndeshet komuniteti rom dhe egjiptian si aksesimi në shëndetësi, arsim, punësim dhe strehim.
3. Monitorimi i mbledhjeve të Këshillit Bashkiak, sidomos në prag të diskutimit për buxhetin.
4. Fokusimi dhe mbështetja e nismave të komunitetit për zgjidhjen e problemeve
5. Ofrimi i platformave për anëtarët e komuniteteve në nevojë për të ndarë përvojat, historitë dhe perspektivat e tyre përmes intervistave, opinioneve apo projekteve të gazetarisë qytetare.
6. Bashkëpunimi me organizatat partnere për të raportuar dhe ndarë me to çështje që lidhen me shëndetin, mjedisin dhe drejtësinë sociale.
7. Lehtësimin e diskutimeve në komunitet dhe organizimin e eventeve ku banorët angazhohen në çështjet lokale dhe në vendim marrje.

8. Ofrimin e trainimit dhe burimeve të qendrës për anëtarët e komunitetit rom dhe egjiptian dhe veçanërisht të të rinjve në mënyrë që ata të jenë në gjendje të tregojnë, publikojnë dhe shpërndajnë historitë e tyre.
9. Krijimi i një databaze për kapacitetet lokale dhe shërbimet që ata mund të ofrojnë në komunitet.

